



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 40, paragrafi 2, pika (a) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008” e në mbështetje të nenit 22, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 27, pika 5, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dispozitave të neneve 15, 28 paragrafi 2, pika (a) lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur me datë, ----- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shfuqizimin e vendimit

Neni 1

MIRATOHET vendimi për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në nëntëdhjetë nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të Komunës, për shkak se fituesi nuk ka pranuar ta nënshkruan kontratën, sipas obligimeve që kanë qenë të parapara në nenin 3, të vendimit të lartcekur.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI